



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane për vitet 2025-2027”

Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (36 tridhjetë e gjashtë) muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime pastrimi 90910000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit i Marrëveshjes kuader për 48 muaj/Vlera e pritshme e kontratës/kontratave është 39,169,904 (Tridhjetë e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e katër) lekë pa TVSH ose **398,878** (Treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) Euro.

Kursi i këmbimit 98.20 Lek/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Prrenjas, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbështetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontratës konkretisht 39,169,904 (Tridhjetë e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e katër) lekë pa TVSH. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021, 2022 dhe 2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në

zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht 13,056,635 (Trembëdhjetë milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa tvsh..

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: a) faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjithë zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara; b) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

2.3.1/3 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4. "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën maksimale 40% të vlerës së fondit limit, që është vlera kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar, vlera për shërbime të ngjashme prej 13,056,635 (Trembëdhjetë milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa tvsh përbën nivelin maksimal prej 40% të përvojes së mëparshme që lejohet LPP, duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK. Vlera prej 40% nuk kufizon aspak konkurrencën dhe është vendosur duke patur parasysh eksperiencat e mëparshme të AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

2.3.2. Operatori/et ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B "Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme". Mbështetur në: Ligjin Nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"). Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin përkatës.

Në rast bashkimi operatorësh të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të disponojnë lejet dhe licensat e mësipërme në raport me përqindjen e marre për kryerjen e kësaj shërbimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi licenca me (kodi III.2.B) është në perputhje me zerat e preventivit dhe specifikimet teknike ku kërkohej pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë fuqi punëtore për realizimin e kontratës prej minimalisht 4 (katër) persona për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;
- Listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi I punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **4 (katër) persona** është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimet si dhe VKM për kohën e punës në muaj për punonjës. Po t’i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë i është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Eshte vendosur qe numri i punonjesve ne dispozicion te operatorit ekonomik per realizimin e kontrates te jete minimalisht **4 (katër) persona** per muajin e fundit pasi kjo kërkesë lidhet me domodoshmërinë për realizimin e objektit te prokurimit, eshte në një numër të justifikuar. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Nr	Specialiteti	Njesi	Sasi
1	Shofere	persona	2
2	Punetore	persona	2
	Shuma		4

1.Operatori ekonomik duhet të disponojë **2 shofere**, përlllogaritur kjo me formulë, duke konsideruar, kohën totale të harxhuar nga një shofer, limituar nga numri i turneve dhe kodi i punës për kohën maksimale të punës dhe kohën e nevojshme për pushim. Jane kerkuar 2 shoferë sipas mjeteve qe duhet te disponoje operatori ekonomik.

2 . Operatori ekonomik duhet të disponojë **2 punetore** per zbrazjen e konteniereve.

Fuqia puntore është përlllogaritur bazuar në legjislacionin në fuqi, e argumentuar nga grupi i punes se perlllogaritjes se fondit limit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë *certifikatat ISO, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001-2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001 -2023 Sistemet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a” - “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues,*

të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- a) Diplomë
- b) CV përkatëse
- c) Kontratë pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij, është shumë e

rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vërtetohen në CV përkatëse të tij. Kriteri I mesipër për eksperiencën e drejtuesit teknik është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorët dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik për të paktën muajin e fundit stafin si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit)
- 2 (dy) Shoferë
- 2 (dy) Punonjës të thjeshtë

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Inxhinieri i Mjedisit: *Kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV;*
- Shoferët: *Kontratë pune e vlefshme, leje drejtimi, certifikate e aftësi profesionale.*
- Punonjësit e thjeshtë: *Kontratë pune e vlefshme.*

Për punonjësit e mësipërme të paraqiten listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të të ardhurave nga punësimi të konfirmuara nga organet tatimore për të paktën muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011" Për mbrojtjen e mjedisit"*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky lloj inxhinieri. Nevoja për inxhinierin mjedisi në objekt është e diktuar nga përvoja e mëparshme, legjislacioni për mjedisin rekomandimeve të APP dhe vendimeve të KPP në lidhje me këto kriter me arsyetimin për mos të ngushtuar konkurrencën. Është vendosur periudha për muajin e fundit pasi konsiderohet e mjaftueshme që ofertuesi të vërtetojë që ka një vazhdimësi në aktivitetin e perdritshëm dhe angazhimin e strukturës së stafit drejtues.

Mungesa e këtij stafit pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e e shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

-1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit dhe deklaratave të mesiperme, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“

Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DT, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që shërbimi të realizohet brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilët janë të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të ofrojnë shërbimin sipas standarteve ligjore në fuqi. Gjithashtu është e nevojshme për të siguruar kushte të sigurt punë për punëtorët dhe për të respektuar rregulloret e sigurisë.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet tipi (emërtimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si më poshtë:

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, **me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton**, jo më pak se 1 (një) copë, me standart **Euro 5**. (në pronësi ose me qira)

- b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, **me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton**, jo më pak se 1 (një) copë, me standart **Euro 5** (rezerve) (në pronësi ose me qira)
- c) Makina për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, **me kapacitet mbajtes jo me pak se 10 ton**, jo më pak se 1 (një) copë, me standart **Euro 5**; (në pronësi ose me qira)
- d) Makine teknologjike me paisje te vecante per larjen e konteniereve 1 (nje) copë: (në pronësi ose me qira)
- e) Kontenierë mbetjesh **201** (dyqind e një) copë.

Për Mjetet teknologjike të kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.
Për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të shërbimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, si dhe dokumenti me të dhënat teknike të mjetit.
Për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të shërbimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku lejon AK të verifikojë mjetet dhe pajisjet para shpalljes së fituesit dhe gjatë zbatimit të kontratës.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, jo më pak se 1 (një) copë. (në pronësi ose me qira)

Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, me standarte **Euro 5, 1 (një) copë**; Kjo ne proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis dhe ka per qëllim uljen e nivelit të ndotjes që shkaktohet në ajër . Respektimin e normativës së ndotjes në ambient, meqënëse janë mjete teknologjike qe punojnë me kohë të zgjatur në qytet dhe për të pasur një nivel të ulët ndotjeje në respektim dhe të normativave teknike të Komunitetit European dhe VKM Nr.154 datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime të V.K.M Nr .633 datë 26.10.2018 të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete.

b) **Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, jo më pak se 1 (një) copë (rezerve) (në pronësi ose me qira)**

Makinë teknologjike transportuese rezerve ne raste avarie , me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, me standarte **Euro 5, 1 (nje) copë**; Kjo ne proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis dhe ka per qëllim uljen e nivelit të ndotjes që shkaktohet në ajër. Respektimin e normativës së ndotjes në ambient, meqënëse janë mjete teknologjike qe punojnë me kohë të zgjatur në qytet dhe për të pasur një nivel të ulët ndotjeje në respektim dhe të normativave teknike të Komunitetit European dhe VKM Nr.154 datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime të V.K.M Nr .633 datë 26.10.2018 të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete.

c) **Makina për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo me pak se 10 ton, jo më pak se 1 (një) copë; (në pronësi ose me qira)**

Makina për freskimin e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 me standarte **Euro 5, 1 (nje) copë**; Kjo ne proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis dhe ka per qëllim uljen e nivelit të ndotjes që shkaktohet në ajër . Respektimin e normativës së ndotjes në ambient, meqënëse janë mjete teknologjike qe punojnë me kohë të zgjatur në qytet dhe për të pasur një nivel të ulët ndotjeje në respektim dhe të normativave teknike të Komunitetit European dhe VKM Nr.154 datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime të V.K.M Nr .633 datë 26.10.2018 të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete.

d) **Makine teknologjike me paisje te vecante per larjen e konteniereve 1 (nje) copë: (në pronësi ose me qira).** Makina për larjen e konteniereve është e rëndësishme për sigurimin e një procesi të

shpejtë, efikas dhe të sigurt për pastrimin e kontenierëve të mbetjeve. Ky mjet ndihmon për të ruajtur higjienën, për të parandaluar kontaminimet dhe për të përmbushur standardet e sigurisë dhe cilësisë.

e) Kontenierë mbetjesh 201(dyqind e një) cope, të domosdoshëm për grumbullimin e mbetjeve të cilat më pas do të transportohen për në incenerator.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit